



Datë: 17.03.2025  
Numër Protokolli: 1778/2025

A.nr.336/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.336/2025 të datës 19.02.2025, të parashtruar nga ankuesi F.Sh., kundër organit të punësimit/Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.03.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Përfundon procedimi administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.336/2025, të datës 19.02.2025, të parashtruar nga ankuesi, F.Sh.

## A r s y e t i m

Ankuesi, F.Sh.(*më tej referuar vetëm* Ankuesi), kandidat për pranim sipas Konkursit me numër Reference RN0015645, të shpalluar më datë 30.10.2024 nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për pozitën e punës “*Drejtor i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave*”, më datë 19.02.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1113/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.336/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me vlerësimin e kësaj procedure rekrutimi.

Tutje, ankuesi më datë 20.02.2025, përmes shkresës me numër protokolli 1150/2025, për arsye personale është tërhequr nga ankesa A.nr.336/2025 e datës 19.02.2025.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 20.02.2025, të ankuesit për tërheqje nga ankesa A.nr.336/2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.336/2025 të datës 19.02.2025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.336/2025, datë 17.03.2025**

**Atdhe GASHI**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit F.Sh.;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.